

Trupi Koordinues për Edukim Financiar dhe Përfshirje Financiare

**Strategjia për edukim financiar dhe
përfshirje financiare
e Republikës së Maqedonisë së Veriut**

2021-2025



Edukimi financiar – kontributi ynë për
përfshirje financiare dhe stabilitet më të madh
financiar

korrik 2021

Hyrje

Sipas përkufizimeve të pranuar ndërkombëtarisht, edukimi financiar është proces i cili duhet të mundësojë njohje më të mirë të produkteve, koncepteve dhe rreziqeve financiare, si dhe zhvillimin e aftësive për përzgjedhje të përshtatshme dhe për të marrë vendime të shëndosha në lidhje me produktet dhe shërbimet financiare dhe menaxhimin e financave personale, e cila në instancë të fundit kontribuon në rritjen e mirëqenies së popullatës. Edukimi financiar është ngushtë i lidhur me përfshirjen financiare, kështu që arsimimi financiar më i lartë, informimi më i mirë dhe gatishmëria për të marrë vendime të mençura dhe të shëndosha financiare në përgjithësi duhet të kontribuojnë në përfshirjen më të lartë financiare. Përfshirja financiare duhet t'u sigurojë qasje adekuate personave juridikë dhe fizikë në lloje të ndryshme të produkteve dhe shërbimeve financiare, të disponueshme në një mënyrë të përshtatshme dhe në kushte të përshtatshme për të gjitha palët (entitetet) e interesuara. Përfshirja më e lartë financiare mundëson përfitim nga shfrytëzimi i produkteve dhe shërbimeve financiare, të cilat përfundimisht duhet të mbështesin zhvillimin ekonomik. Përfshirja financiare kushtëzohet në mënyrë të pashmangshme edhe nga mbrojtja e të drejtave të konsumatorit ndaj produkteve dhe shërbimeve të ndryshme financiare. Sistemi i mbrojtjes së konsumatorit në fushën e financave përfshinë legjislacionin e duhur dhe strukturën institucionale që sigurojnë mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit, konkurrencën e ndershme në treg dhe shkëmbimin e lirë të informacionit, si parakushte të rëndësishme për mbrojtjen e konsumatorit, veçanërisht për mbrojtjen e individëve që nuk kanë njohuri të mjaftueshme dhe ekspertizë për të mbrojtur vet të drejtat e tyre.

Edukimi financiar dhe mbrojtja e konsumatorëve janë segmente plotësuese dhe duhet të mbështesin përfshirjen financiare. Parakusht kryesor për përfshirje më të madhe financiare është kryesisht sistemi financiar i shëndoshë, i qëndrueshëm dhe efikas. Njëkohësisht, klientët e edukuar dhe të informuar mirë, të cilët menaxhojnë më mirë me financat e tyre gjithashtu kontribuojnë në stabilitetin financiar. Rreziku i vendimeve të paqëndrueshme financiare, si pasojë e edukimit financiar të pamjaftueshëm në nivel individual dhe familjar, ka një ndikim negativ në sektorin financiar, gjë që e bën të domosdoshme zbatimin e kësaj strategjie në nivel kombëtar.

Kjo strategji ka për qëllim të sigurojë mbështetje dhe zhvillim të mëtejshëm të edukimit financiar dhe përfshirjes financiare, si dhe përmirësim dhe/ose vendosje të kornizës përkatëse ligjore dhe institucionale për mbrojtje të konsumatorëve në sferën e financave në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Strategjia duhet të kontribuojë në forcimin e koordinimit dhe bashkëpunimit midis rregullatorëve financiar, sektorit financiar privat dhe sektorit joqeveritar, si dhe qasjes sistematike të të gjitha subjekteve të përfshira në mënyrë që të forcojë edukimin financiar të popullatës, të përmirësojë nivelin e përfshirjes financiare, duke siguruar mbrojtje adekuate të konsumatorit. Bashkëpunimi midis njësive të përfshira do të kontribuonte në optimizimin e burimeve, vazhdimësinë e përpjekjeve dhe rritjen e përgjegjësisë kolektive në

lidhje me qëllimet e përcaktuara. Strategjia është e fokusuar si në sektorin financiar ashtu edhe në përdoruesit e shërbimeve dhe produkteve financiare.

Strategjia merr parasysh praktikat pozitive botërore në këtë sferë, si dhe rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare (OECD, Banka Botërore, institucionet e BE-së).

1. Qëllimet e strategjisë

Qëllimet bazë të strategjisë janë:


- Të kontribuojë për njohje më të mirë të koncepteve themelore financiare dhe nocioneve tek grupet individuale të synuara dhe të popullsisë në tërësi;
- Të përforcojë shkathtësitë e popullatës për menaxhim me financat personale;
- Të përmirësojë aftësinë e popullatës për sjellje të vendimeve të drejta në lidhje me produktet dhe shërbimet e ndryshme financiare;
- Të përmirësojë ndërgjegjësimin e popullatës për përparësitë dhe rreziqet e përdorimit të produkteve dhe shërbimeve të ndryshme financiare, duke forcuar besimin e tyre në sistemin financiar;
- Të përmirësojë disiplinën financiare të popullatës, gjegjësisht të përvetësojë shprehi të kursimit, shpenzim dhe humarrje me përgjegjësi, si dhe kujdes të përgjithshëm gjatë përdorimit të të gjitha produkteve dhe shërbimeve financiare të ofruara në treg;
- Të mbështesë përfshirjen financiare, përmes zhvillimit të mëtejshëm të segmenteve financiare individuale, të siguroj informacion më të gjerë në lidhje me produktet dhe shërbimet financiare, duke mbrojtur në mënyrë adekuate të drejtat e konsumatorëve në sektorin financiar;
- Të përforcojë vetëdijësimin për kërkimin e informatave shtesë, si dhe nevojën për edukim të vazhdueshëm në sferën e financave, si një sferë ekskluzivisht dinamike e ekonomisë;
- Të përmirësojë kornizën ligjore ekzistuese dhe strukturën institucionale për krijimin e një sistemi të mbrojtjes së të drejtave të konsumatorit në fushën e financave.

2. Situata Aktuale

Arsimimi financiar

Matja e parë nacionale e nivelit të arsimimit financiar tek popullata e rritur në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e kryer në shkurt të vitit 2018¹, tregoi nivel të përgjithshëm të arsimimit financiar prej 11,8, në përputhje me metodologjinë standarde të INFE. Ky është nivel relativisht i ulët në krahasim me mesataren e vendeve më të zhvilluara në botë nga Grupacioni 20 deri më 12,7 pikë, mirëpo nga ana tjetër është i krahasueshëm me vendet e rajonit.

Grafiku 1




Studimi i nivelit të arsimimit financiar në vitin 2018 është kryer përmes ekzaminimit të tre komponenteve më të rëndësishme të cilat janë pjesë përbërëse e arsimimit financiar: njohuri financiare, sjellje financiare dhe qëndrime financiare. Për sa i përket komponentëve të indeksit të përgjithshëm, në Republikën e Maqedonisë së Veriut në fushën e njohurive financiare dhe sjelljes financiare, u panë rezultate solide, në përputhje me pjesëmarrjen e të anketuarve me pikat minimale të synuara (pragu minimal i kënaqshëm). Kështu, 45% e të anketuarve treguan njohuri solide për konceptet themelore financiare, gjë që kontribuon në vendime të shëndosha financiare. Gjithashtu, 42% e të anketuarve kanë sjellje financiare pozitive, ndër të tjera të shprehura përmes rregullsisë në pagesën e faturave të amvisërive dhe shqyrtimin e më shumë opcioneve kur zgjedh një shërbim të veçantë financiar. Nga ana tjetër, qëndrimet financiare tregojnë performancë më të ulët, domethënë vetëm 20% e të anketuarve kanë qëndrime pozitive në kontekstin e arsimimit financiar, e cila tregon kryesisht përqendrimin e shumicës së popullatës në nevojat financiare afatshkurtra, dhe jo në kursimet afatgjata. Edhe pse qëndrime të tilla mund të pasqyrojnë situatën socio-ekonomike të popullatës dhe standardet e jetesës, ky aspekt megjithatë lë hapësirë për ngritjen e nivelit të edukimit financiar në këtë fushë.

¹ Matja e parë ishte në organizim të Bankës Popullore, e me mbështetje të EFSE, sipas metodologjisë ndërkombëtare të INFE-OECD.

Matja e dytë e nivelit të arsimimit financiar të popullatës së rritur në Republikën e Maqedonisë së Veriut është kryer në gjysmën e dytë të vitit 2019². Rezultatet e marra nga të dyja matjet janë të krahasueshme, duke qenë se e njëjta metodologji është përdorur në të dy sondazhet. Duke marrë parasysh se bëhet fjalë për periudhë relativisht të shkurtë kohore në të cilën janë realizuar të dyja matjet, rezultati i përgjithshëm është i njëjtë. Gjegjesisht, popullata në Republikën e Maqedonisë së Veriut edhe në vitin 2018 edhe në vitin 2019 ka realizuar 56% të maksimumit, ose treguesit agregat 11,8 (nga të cilët 3,9 për njohuri financiare, 5,1 për sjellje financiare dhe 2,8 për qëndrime financiare). Në krahasim me strukturën e indikatorit në vitin 2018, ka vetëm lëvizje të vogla (në vitin 2018 tek njohuritë financiare 4, për sjelljen financiare 5 dhe nivel të njëjtë prej 2,8 për qëndrimet financiare). Rezultatet nga anketa e parë dhe e dytë tregojnë se nevojitet më shumë informacion dhe edukim i popullatës për përdorimin e produkteve dhe shërbimeve të ndryshme moderne bankare dhe produkteve dhe shërbimeve tjera financiare.

Grafiku 2




Rezultatet nga studimi në vendin tonë zbulojnë një zbrazëtim midis niveleve të arsimimit tek grupet e ndryshme të popullatës, duke theksuar nevojën për qasje të diversifikuara gjatë edukimit financiar të grupeve të ndryshme të synuara. Poashtu, niveli i njohurive financiare, sipas pikave minimale të synuara, është më i ulët tek gratë sesa tek burrat, njëkohësisht është më i ulët tek popullata me arsim më të ulët dhe tek popullata me të ardhura më të ulëta (gjetje të ngjajshme edhe për vendet/rajonet tjera).

² Matja e dytë e arsimimit financiar u zbatua në kuadër të projektit rajonal për edukim financiar të mbështetur nga Ministria e financave e Holandës dhe INFE-OECD.

Përfshirja financiare dhe mbrojtja e konsumatorit


Përfshirja financiare në Republikën e Maqedonisë së Veriut, sipas matjes së bazës së të dhënave të Bankës Botërore - Findex për vitin 2017, e shprehur përmes numrit të personave me llogari bankare, është relativisht e lartë ku në vitin 2017 ishte 76.6%, e cila është mjaft e krahasueshme me mesataren e Evropës dhe Azisë Qendrore (EAQ) prej 81.5%. Nga ana tjetër, përfshirja financiare e huamarrjes është më e ulët, në të njëjtën kohë më e ulët në EAQ. Kështu, huamarrja nga institucionet financiare është relativisht modeste. Megjithatë, kur analizohet përfshirja financiare në huamarrje, niveli i zhvillimit të sistemit financiar nuk duhet lënë anash.

Grafiku 3




Përfshirja financiare në lidhje me kartelat për pagesë në Republikën e Maqedonisë së Veriut është më e lartë tek kartelat debitore, kundrejt kartelave kreditore, që pjesërisht pasqyron vetitë e ndryshme dhe kriteret e ndryshme për marrjen e këtyre kartelave, ku proporcioni i tillë në dobi të kartelave debitore ekziston edhe në EAQ. Megjithatë, niveli i përfshirjes në raport me përdorimin e kartelave për blerje është ndjeshëm më i ulët në vendin tonë kundrejt EAQ, që konfirmohet edhe me faktin se tek ne është e konsiderueshme pjesëmarrja e transaksioneve me kartela për tërheqje të parave nga bankomatet (me një trend në rënie vitet e fundit), gjë që tregon përdorimin jo të plotë të përfitimeve të këtij instrumenti pagese pa para në dorë dhe gjithashtu vën në dukje nevojën për edukim më të madh financiar në këtë fushë. Gjetjet nga sondazhet e Bankës Botërore gjithashtu vën në dukje një përfshirje relativisht më të ulët të popullatës maqedonase kur bëhet fjalë për përdorimin e shërbimeve financiare dhe pagesave online.

Grafiku 4



Analiza e përgjigjeve të të anketuarve në kuadër të anketës për arsimim financiar e vitit 2018 tregon se sa i përket produkteve dhe shërbimeve financiare më të reja ose më të sofistikuara popullata ka më pak njohuri, në krahasim me njohuritë për produktet klasike, kurse për shumicën e produkteve dhe shërbimeve financiare, edhe pse vetëdijësimi është solid, megjithatë përdorimi është ndjeshëm më i vogël. Këto të dhëna tregojnë për nevojën për informim më të mirë të popullatës në raport me përparësitë, por edhe për rreziqet nga produktet më të reja financiare në treg, me çfarë do të sigurohej përfshirje më e madhe financiare në segmente të ndryshme financiare.

Grafiku 5



Të dhënat mbi nivelin relativisht të lartë të përfshirjes financiare në aspektin e posedimit të llogarisë bankare tregojnë një bazë të mirë për përparim të mëtejshëm në këtë fushë. Niveli i lartë i përfshirjes financiare është thelbësor për vendin, dhe kërkon angazhim dhe koordinim

të fortë midis institucioneve përkatëse dhe subjekteve private në mënyrë që të krijohet qasje e lehtë në financa dhe politika të gjera që promovojnë sjellje të përgjegjshme financiare.

Mbrojtja e të drejtave të konsumatorëve, së bashku me edukimin financiar dhe qasjen deri te shërbimet financiare, paraqet bazë për përfshirje më të madhe financiare. Mbrojtja e konsumatorëve përfshinë: sigurimin e informatave të sakta dhe në kohë konsumatorëve për vendimmarrje të bazuar në informacion, mungesën e praktikave të padrejta dhe mashtruese të kontratave dhe qasjen në mekanizma për zgjidhjen e shkeljeve të të drejtave të konsumatorit.

Rregulloret nga të cilat dalin kompetencat për të vepruar në fushën e mbrojtjes së konsumatorit në vendin tonë, veçanërisht në kontekst të përdoruesve të shërbimeve financiare, janë Ligji për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe aktet nënligjore që dalin prej tij, si dhe Ligji për Mbrojtjen e Konsumatorit gjatë marrëveshjeve për kredi konsumatore (e cila është plotësisht në përputhje me Direktivën Evropiane 2008/48/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 22 majit 2008) dhe akteve nënligjore përkatëse. Banka Popullore si organ rregullator dhe mbikëqyrës është njëra nga institucionet (së bashku me Ministrinë e ekonomisë dhe Ministrinë e financave) me kompetenca për kontroll të zbatimit të Ligjit për mbrojtje të konsumatorëve gjatë marrëveshjeve për kredi konsumatore. Banka Popullore është organ kompetent për të kontrolluar zbatimin e këtij ligji nga ana e bankave dhe shtëpive të kursimit gjatë miratimit të kredive konsumatore. Kështu, mbikëqyrja nga Banka Popullore zbatohet në kuadër të mbikëqyrjes prudente. Raporti për progres i Komisionit evropian për vendin tonë i vitit 2019 tregon për nevojën "për vazhdim të angazhimeve për harmonizim të rregullativave kombëtare me ato evropiane në lidhje me mbikëqyrjen prudente për mbrojtje të konsumatorëve dhe parandalimin e praktikave të padrejta bankare". Në sektorin e sigurimeve, baza ligjore e aktiviteteve për mbrojtje të konsumatorit mundësohet nga Ligji për Mbikëqyrjen e Sigurimeve. Në sektorin e letrave me vlerë, mbrojtja ligjore e përdoruesve të shërbimeve në tregun e letrave me vlerë mundësohet me Ligjin e letrave me vlerë, Ligjin për marrje të shoqërive aksionare dhe Ligjin e fondeve investuese. Komisioni i letrave me vlerë i Republikës së Maqedonisë së Veriut si një organ rregullator ka kompetenca për të kontrolluar zbatimin e këtyre ligjeve dhe të kujdeset për funksionimin ligjor dhe efikas të tregut të letrave me vlerë dhe mbrojtjen e të drejtave të përdoruesve të tij, me qëllim të përforcimit të vazhdueshëm të besueshmërisë së publikut në institucionet e tregut të letrave me vlerë.

3. Rishikim i aktiviteteve të deritanishme

Në vitin 2013 u formua Trupi koordinues i institucioneve rregullatore për edukim financiar me qëllim të përforcimit të bashkëpunimit midis institucioneve rregullatore në sferën e edukimit financiar. Në Trupin koordinues marrin pjesë: Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut (BPRMV), Ministria e financave (MF), Agjencia e mbikëqyrjes së sigurimeve (AMS), Komisioni i letrave me vlerë (KLV) dhe Agjencia për mbikëqyrjen e financimit kapital të

sigurimit pensional (MAPAS). Në vitin 2019, Trupi koordinues i rriti kompetencat e veta edhe në sferën e përfshirjes financiare dhe u riemërua në Trup koordinues për edukim financiar dhe përfshirje financiare. Në këtë periudhë u ndërmorrë një numër i madh nismash për ngritjen e nivelit të arsimimit financiar të popullatës dhe përfshirjes më të madhe financiare në vend. Aktivitetet janë të fokusuara në fushat e mëposhtme:

- Inkurajim i bashkëpunimit midis institucioneve që janë pjesë e Trupit Koordinues dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera përkatëse përmes zbatimit të programeve dhe aktiviteteve edukative për të mbështetur dhe përmirësuar arsimimin financiar të popullatës;
- Bashkëpunim në projekte të përbashkëta për edukimin financiar dhe përfshirjen;
- Hartim i dokumenteve strategjike;
- Matje e nivelit të arsimimit financiar dhe përfshirjes financiare të popullatës;
- Realizim i sesioneve të punës, seminareve, ligjëratave dhe evente të tjera publike;
- Promovim i bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar.

Ekzistojnë disa aktivitete të përbashkëta për edukim dhe përfshirje financiare që koordinohen nga ana e institucioneve të Trupit koordinues, çdo vit në periudhë të caktuar kohore, siç janë: „Java globale e parasë“ në muajin mars, „Ditët e arsimimit financiar“ në muajin maj, shënimi i Ditës ndërkombëtare të kursimit më 31 tetor dhe i Ditës së sigurimeve më 1 nëntor. Në vitet e fundit, aktivitetet zgjerohen përmes përfshirjes edhe të popullatës së moshuar. Në vitin 2019, Ditët e arsimimit financiar u organizuan për të gjithë qytetarët e interesuar. Poashtu, rregullatorët financiar bashkëpunojnë edhe gjatë hartimit të publikimeve edukative, e njëherit përmes Trupit koordinues janë të përfshirë në projektin rajonal për edukim financiar të Ministrisë së financave të Holandës (në kuadër të Konstituencës pranë FMN-së), në bashkëpunim me INFE-OECD. Rregullatorët financiarë mbajnë ligjërata/prezantime të rregullta për nxënësit e arsimit fillor dhe të mesëm, si dhe ligjërata të specializuara për studentë nga sfera e financave, me çfarë kontribuojnë për plotësimin e diturive të të rinjve për këtë sferë³.

Poashtu, ekzistojnë edhe një numër i organizatave jofitimprurëse dhe private të cilat zbatojnë programe për edukim financiar mbi tema të ndryshme nga fusha e veprimtarisë së tyre, ku një pjesë e madhe e tyre tani për tani nuk janë të koordinuar në nivel nacional. Në vitin 2019, në nismë të sektorit privat bankar, në bashkëpunim me një pjesë të rregullatorëve financiar, filloi të organizohet Kuizi Evropian i Parasë për fëmijë të grupmoshës prej 13 deri 15 vjet. Numër i madh i subjekteve nga sektori privat (banka, fonde pensione, fonde investuese, shoqëri për sigurime, ndërmjetës në sigurimet, institucione mikrofinanciare) ofrojnë aktivitete edukative, veçanërisht për popullatën e re. Megjithatë, nuk dihet se çfarë është dhe cili është ndikimi i secilës prej nismave ose programeve në nivelin e arsimimit financiar të popullatës.

³ Në sistemin ekzistues arsimor, edukimi financiar është i kyçur pjesërisht përmes aspekteve të veçuara në kuadër të lëndëve Shkathtësitë e jetesës, Matematika, Shoqëria, Ndërmarrësia dhe inovacione në arsimin fillor.

Në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve, vërehet nevoja për plotësim të rregullativës ekzistuese dhe harmonizimi i saj me standardet evropiane në këtë sferë. Vëmendje e veçantë nevojitet në lidhje me çështjet e përcaktimit të një mandati të qartë të institucioneve rregullatore për mbikëqyrjen e duhur të këtij segmenti të operacioneve, si dhe mbulimin adekuat me rregullimin e duhur të llojeve të ndryshme të produkteve dhe shërbimeve financiare që ekzistojnë në treg. Sfidë e veçantë për rregullatorët paraqet vendosja e mbikëqyrjes së praktikave afariste (angl. market conduct supervision) të subjekteve financiare me një fokus të qartë në mbrojtjen e të drejtave të klientëve, si dhe ndarjen e tij nga mbikëqyrja prudente që synon ruajtjen e stabilitetit të sistemit. Edhe pse në nivel kombëtar ekziston kornizë e caktuar rregullativash dhe aktivitetet ndërmerren nga disa institucione rregullatore, ende nuk ka një sistem për mbrojtje të centralizuar dhe të koordinuar të konsumatorëve përdorues të shërbimeve financiare, përfshirë sistemin për zgjidhjen ligjore të ankesave nga klientët e sistemit financiar. Edhe pse përvojat në çdo vend janë të ndryshme, megjithatë përparësi i jepet ekzistimit të një trupi të pavarur i cili është i specializuar për shqyrtim dhe vendimmarrje objektive të ankesave nga klientët në institucionet financiare (që është përfshirë edhe në gjetjet e misionit FSAP të FMN-ës dhe Bankës Botërore, të vitit 2018). Aspektet lidhur me të drejtat e klientëve, së bashku me transparencën dhe zbatimin e praktikave të drejta nga ana e subjekteve private financiare, në kushte bashkëkohore, janë faktor i rëndësishëm për besueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e sistemit financiar, si një nga bartësit e zhvillimit ekonomik.

4. Aktivitetet dhe masat për përmirësimin e edukimit financiar dhe përfshirjes financiare

4.1. Aktivitete dhe masa për përmirësimin e edukimit financiar

1. Përforcimi i vetëdijes për edukimin financiar në bazë të gjerë, me përfshirje të të gjitha institucioneve dhe subjekteve të interesuara financiare, asociacione, organizata joqeveritare, të cilat mund të ofrojnë programe arsimore për popullatën, në të gjithë vendin. Paralelisht, përforcim i koordinimit të subjekteve të përfshira në procesin e edukimit, në mënyrë që të optimizohen burimet dhe të ofrohen programe të ndryshme arsimore në përputhje me nevojat e ndryshme të popullatës.

Masa: inkuadrim i regjistrit të subjekteve të cilat janë aktive në fushëveprimin e edukimit financiar, përfshirë edhe mundësinë për e-regjistrim.

Institucionet kompetente: Trupi koordinues për edukim dhe përfshirje financiare, secili institucion rregullator në fushëveprimin e tij;

2. Vendosja e kompetencave bazë në sferën e financave, të cilat duhet të zhvillohen dhe të plotësohen përmes programeve për edukim financiar. Kompetencat duhet të jenë të përpunuara në mënyrë të veçantë për të gjitha grupmoshat, filluar nga mosha parashkollore, më pas për nxënësit e arsimit fillor dhe të mesëm, si dhe për popullsinë e moshuar.

Masa: përkufizim i grupmoshave, vendosje e kompetencave bazë për sfera të ndryshme të financave.

Institucionet kompetente: institucionet rregullatore të sistemit financiar;

3. Promovim dhe zhvillim i praktikave të mira në fushëveprimin e edukimit financiar në lidhje me programet arsimore të subjekteve të caktuara të cilat kanë aktivitete arsimore. Programet për edukim financiar duhet të hartohen për të plotësuar nevojat për arsimim financiar të publikut të synuar. Edukimi financiar duhet të konsiderohet si një proces i përjetshëm, i vazhdueshëm, veçanërisht duke marrë parasysh kompleksitetin në rritje të tregjeve, nevoja të ndryshme financiare në faza të ndryshme të jetës së njerëzve dhe nevojën për informacione të ndryshme për menaxhim optimal me financat personale. Me përpunimin dhe pranimin e një Kodi të praktikës së mirë sigurohen programe arsimore cilësore, qasje të përkushtuar dhe korrekte nga të gjitha subjektet e përfshira në procesin arsimor, përfshirë shoqërinë private dhe shoqërinë civile.

Masa: ngritja e vetëdijes dhe inkurajimi i të gjitha subjekteve potenciale që mund të kryejnë trajnime të tilla, përcaktimi i procedurave për rishikimin e programeve arsimore, përgatitja e një dokumenti (kodi) për praktikën e mira në fushën e edukimit financiar dhe miratimi i tij nga subjektet që kryejnë veprimtari edukative, zbatim të qasjes për selektim të praktikave më të mira të edukimit përmes testimit në praktikë.

Institucionet kompetente: Trupi koordinues për edukim dhe përfshirje financiare, secili institucion rregullator në fushëveprimin e tij;

4. Përpunim i mëtejshëm dhe botim i materialeve edukative, të shkruara në një gjuhë të lehtë për t'u kuptuar, që mbulojnë temat aktuale në fushën e financave, të publikuara në mënyrë që të sigurohet qasje për një pjesë më të madhe të popullatës. Nevojitet përqëndrim i veçantë i edukimit në lidhje me produktet dhe shërbimet bashkëkohore financiare.

Masa: ndërgjegjësimi i të gjitha subjekteve përkatëse që mund të kontribuojnë në këtë fushë, monitorimi i përvojës botërore në fushën e prodhimit dhe kanaleve për shpërndarjen e materialeve edukative për popullatën e përgjithshme.

Institucionet kompetente: institucionet rregullatore të sistemit financiar, sektori privat financiar, organizatat joqeveritare;

5. Aktivitete të mëtejshme për studimin e edukimit financiar në procesin arsimor, përmes një lënde të veçantë ose përfshirjes së segmenteve të caktuara në lëndët ekzistuese (që në kushtet ekzistuese është pjesërisht e pranishme) në arsimin fillor dhe të mesëm.

Masa: trajnime për kuadrin arsimor, zhvillim i materialeve edukative arsimore, bashkëpunim me ministritë kompetente.

Institucionet kompetente: Ministria e arsimit dhe shkencës, Trupi koordinues për edukim dhe përfshirje financiare, çdo institucion rregullator në fushëveprimin e vet;

6. Rritje e arsimimit financiar tek popullata e moshuar, përmes përkufizimit të grupeve të synuara (siç është popullata femërore, të papunësuarit, etj) dhe hartim i disa moduleve të kurseve me qëllim të edukimit përkatës dhe informim më i mirë nga sfera e financave.

Masa: përcaktimi i grupeve të synuara dhe trajnimet e duhura në fushën e financave, përgatitja e materialeve të përshtatshme arsimore.

Institucionet kompetente: institucionet rregullatore të sistemit financiar, sektori privat financiar, shoqatat, organizatat joqeveritare;

7. Rritja e ndërgjegjësimit të subjekteve private nga sektori financiar për rritjen e aktiviteteve me qëllim edukimin dhe informimin e klientëve në mënyrë më të detajuar për të gjitha aspektet që lidhen me produktet financiare. Nevojitet koordinim i përforcuar i institucioneve rregullatore dhe subjekteve nga sektori privat në fushëveprimin e edukimit financiar dhe informim të klientëve, si dhe shqyrtim i aktiviteteve përkatëse për këtë qëllim, duke ndjekur praktikën e mira në këtë sferë.

Masa: përkufizimi i sferave në të cilat nevojitet angazhim më i madh i subjekteve private me qëllim të përmirësimit të njohurive financiare të klientëve, si dhe mënyra në të cilat do të zbatohet edukimi financiar i klientëve (ligjërata, pyetësorë, këshilla).

Institucionet kompetente: sektori privat financiar, secili institucion rregullator në fushëveprimin e vet;

8. Rritja e ndërgjegjësimit të popullatës për llojet e ndryshme të produkteve financiare dhe rreziqet individuale në fushën e përdorimit të produkteve dhe shërbimeve financiare, në mënyrë që të forcohet aftësia për zgjedhjen e duhur dhe sjelljen e përshtatshme në fushën e menaxhimit me financa personale.

Masa: aktivitete përkatëse edukative për produktet financiare individuale dhe për rreziqet në segmentet e caktuara financiare.

Institucionet kompetente: secili institucion rregullator në fushëveprimin e vet, sektori privat financiar, shoqatat, organizatat joqeveritare;

4.2. Aktivitetet dhe masat për rritjen e përfshirjes financiare

1. Analiza e rregullativës për mbrojtje të konsumatorëve në sfera të veçura të sistemit financiar dhe zhvillim i rregullativës përkatëse gjithëpërfshirëse për mbrojtje të konsumatorëve në sferën e financave. Njëkohësisht, nevojitet organizim përkatës dhe ekipim kadrovik në institucionet rregullatore të sistemit financiar në këtë segment.

Masa: krijimi i bazave ligjore për mbrojtje të konsumatorëve në sferën e financave, ndjekje e kërkesave të BE-së në këtë fushëveprim.

Institucionet kompetente: institucionet rregullatore të sistemit financiar, secili institucion rregullator në fushëveprimin e vet;

2. Rregullativa përkatëse në fushëveprimin e shërbimeve të pagesave dhe aplikimi i praktikave botërore të mbrojtjes së konsumatorit në këtë fushë .

Masa: krijimi i bazave ligjore për mbrojtje të konsumatorëve në sferën e shërbimeve pagesore, ndjekje e kërkesave të BE-së në këtë fushëveprim.

Institucionet kompetente: institucionet rregullatore të sistemit financiar, secili institucion rregullator në fushëveprimin e vet;

3. Përforcimi i komunikimit me konsumatorët në sferën e financave, me qëllim të perceptimit më të mirë të nevojave të tyre dhe reagim ndaj ankesave të tyre.

Masa: inkuadrimi i mundësisë në faqen e internetit të secilit subjekt privat financiar (ose rregullator) për dërgimin e ankesave/lëvdëratave, përkufizimi i mënyrës së shqyrtimit të ankesave dhe përgatitje e përgjigjeve për klientët.

Institucionet kompetente: secili institucion rregullator në fushëveprimin e vet, sektori privat financiar, shoqatat;

4. Aktivitete rreth inkuadrimin dhe përforcimit gradual të mbikëqyrjes së mbrojtjes së konsumatorit në segmente të caktuara të sektorit financiar. Njëkohësisht, nevojitet

edhe organizim përkatës dhe ekipim kadrovik edhe i subjekteve private financiare në këtë fushëveprim.

Masa: trajnime të kuadrit, duke ndjekur tendencat botërore në këtë sferë.

Institucionet kompetente: secili institucion rregullator në fushëveprimin e vet;

5. Rritje e transparencës në punë dhe në publikimin e të dhënave për shërbime financiare nga ana e sektorit privat financiar, përfshirë edhe standardizimin e të dhënave të publikuara për të njëjtin lloj të shërbimit.

Masa: shqyrtim i të dhënave të publikuara për secilin shërbim dhe përgatitjen e një formulari me të gjitha të dhënat e nevojshme, i cili do të kërkohet nga secili subjekt privat financiar në segmentin përkatës të tregut.

Institucionet kompetente: secili institucion rregullator në fushëveprimin e vet, sektori privat financiar, shoqatat;

6. Shqyrtim i mundësive ligjore (si ndërmjetësim) për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të mundshme me konsumatorët, përfshirë edhe shqyrtimin e mundësisë së krijimit të Avokati të Popullit (Ombudsman-i) për sektorin financiar.

Masa: shqyrtim i përvojave nga vendet tjera, krijimin e parakushteve përkatëse ligjore.

Institucionet kompetente: aktivitet i koordinuar i institucioneve rregullatore të sistemit financiar;

7. Krijimi i bazës statistikore për numrin dhe llojin e ankesave, sipas subjekteve të caktuara ligjore, në segmente të caktuara të sistemit financiar.

Masa: përcaktimi i procedurave për grumbullim ose informim për numrin dhe llojin e ankesave, sipas subjekteve të caktuara financiare.

Institucionet kompetente: secili institucion rregullator në fushëveprimin e vet;

8. Krijimi i parakushteve për përmirësim dhe monitorim më të përshtatshëm të qasjes në financa nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe grupet e tjera të synuara, me rëndësi të veçantë për zhvillimin e ekonomisë dhe rritjen e përfshirjes financiare.

Masa: inkuadrimi i anketave, pyetësorëve dhe përdorimi i burimeve të tjera të të dhënave (regjistri kreditor).

Institucionet kompetente: institucionet rregullatore të sistemit financiar;

9. Aktivitete për përforsimin e aftësive të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme për huamarrje, të cilat duhet të lehtësojnë aksesin e tyre në burimet financiare dhe rrjedhimisht të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të këtij segmenti dhe ekonomisë në tërësi.

Masa: vendosja e një skeme kreditore garantuese, rritje të praktikave menaxheriale dhe standardeve kontable për këto firma.

Institucionet kompetente: ministritë kompetente;

10. Aktivitete për mbështetje dhe stimulim të inovacioneve financiare, me qëllim të zhvillimit të mëtejshëm të sektorit financiar dhe shërbimeve, duke siguruar kështu përfshirje më të madhe.

Masa: koordinim midis institucioneve rregullatore të sistemit financiar dhe sektorit privat financiar, krijim i parakushteve përkatëse ligjore.

Institucionet kompetente: aktivitet i koordinuar i institucioneve rregullatore të sistemit financiar;

11. Lehtësim i qasjes në financat për klientëve nga zonat e thella rurale.

Masa: shqyrtim i mundësive për qasje më të mirë të klientëve deri te produktet dhe shërbimet financiare, analizë e përvojave nga vende tjera.

Institucionet kompetente: sektori privat financiar, shoqatat;

12. Rritja e vetëdijësimit për të drejtat e konsumatorëve në segmente të caktuara të sistemit financiar, përmes edukimit përkatës financiar;

Masa: lidhur me aktivitetet në pjesën për edukim financiar.

Institucionet kompetente: institucionet rregullatore të sistemit financiar dhe sektori privat financiar.

9. Monitorim i zbatimit të strategjisë

Zbatimi i aktiviteteve të parapara në Strategji do të mundësonte përfitime të numërta, të shprehura përmes: informimit më të mirë për produktet dhe shërbimet financiare; njohuri

më të mëdha për produktet dhe shërbimet bashkëkohore financiare; vetëdijësim i përforcuar për rreziqet e mundshme gjatë përdorimit të produkteve të veçuara financiare dhe mbrojtja përkatëse nga ato; përforsim i aftësisë për të sjellë vendime të qëndrueshme financiare nga ana e popullatës rrjedhimisht ruajtjen e stabilitetit financiar dhe rritjen e mirëqenies.

Zbatimi i aktiviteteve të parapara në Strategji do të monitorohet përmes disa treguesve, duke përfshirë sa vijon:

1. Monitorim i numrit të personave të kyçur në trajnime, ligjërata, prezantime;
2. Pyetësor për njohuri para dhe pas trajnimeve, përfshirë edhe vlerësim të trajnimeve dhe programeve individuale;
3. Sondazhe dhe pyetësorë të kohë pas kohshme të popullatës;
4. Monitorimi i treguesve për edukimin financiar dhe përfshirjen nga burimet statistikore zyrtare (vendase dhe të huaja);
5. Monitorim i zbatimit të masave të parapara në planet vjetore të veprimit të secilit nga institucionet e përfshira rregullatore.

Çdo institucion rregullator do të ndërmerr masa për monitorim të aktiviteteve në fushëveprimin e tij, ndërsa subjektet private të përfshira si dhe shoqatat qytetare do të informonin për aktivitetet e zbatuara. Për çdo vit të zbatimit të Strategjisë, rregullatorët financiar përgatisin plan të aktiviteteve (në dhjetor, për vitin e ardhshëm), ndërsa çdo vit përgatitet Raport për aktivitetet e zbatuara (deri në shkurt të vitit aktual, për vitin paraprak).⁴ Subjektet nga sektori privat dhe civil informojnë për aktivitetet e tyre një herë në vit (deri në shkurt të vitit aktual, për vitin paraprak) ose rrjedhimisht, pas përfundimit të aktivitetit.

Raportet për aktivitetet e caktuara të të gjitha subjekteve të përfshira duhet të përmbajnë të dhëna për llojin e aktivitetit, përshkrim të përmbajtjes edukative, numrin e personave të përfshirë, sipas mundësisë edhe vlerësim të aktivitetit. Secili institucion i përfshirë në zbatimin e masave dhe aktiviteteve të parapara me Strategjinë duhet të planifikojë burime përkatëse financiare për realizimin e tyre.

Me qëllim të monitorimit të zbatimit të Strategjisë do të formohet grup punues për monitorim të zbatimit të Strategjisë. Ky grup punues do të përbëhet nga përfaqësues të institucioneve rregullatore, shoqatave të sektorit privat dhe sektorit joqeveritar. Qëllimi i tij do të jetë që së

⁴ Planet e aktiviteteve të rregullatorëve financiar për vitin 2021 janë të përpiluara në dhjetor të vitit 2020, duke marrë parasysh Propozim-Strategjinë dhe janë të dorëzuara drejtuar Trupit koordinues për edukatë financiare dhe përfshirje financiare.

paku dy herë në vit të takohen për të vendosur prioritetet dhe të vlerësojë detyrat e kryera gjatë vitit. Grupi punues do të ketë detyrë që një herë në vit të përgatit dhe të dorëzojë raport gjithëpërfshirës për zbatimin e Strategjisë deri te të gjitha institucionet e pëfshira.

Shtojca 1: Listë e lidhjeve të dobishme të internetit për përpunim të masave dhe aktiviteteve në segmente të veçuara

Titulli	Lidhja
1. <i>OECD's core competencies on financial literacy (2015-2019)</i>	<u>Lidhje deri te faqja e internetit e INFE-OECD – Udhëzues për kompetencat kyçe (për investitorë (2019), për NVM-të (2018), për popullatën e rritur (2016) dhe popullatën e re (2015))</u>
2. <i>OECD's guidelines for private and not-for-profit stakeholders in financial education (2014)</i>	<u>Lidhje deri te OECD – Udhëzues për kyçjen e sektorit privat në edukimin financiar</u>
3. <i>OECD's High-level principles on financial consumer protection (2011)</i>	<u>Lidhje deri te G20/INFE-OECD – Parimet e mbrojtjes së konsumatorëve financiar</u>
4. <i>G20/OECD's Ensuring financial education and consumer protection for all in the digital age (2017)</i>	<u>Lidhje deri te G20/INFE-OECD – Raport për sigurimin e edukimit financiar dhe mbrojtjen e konsumatorëve gjatë digjitalizimit</u>
5. <i>G20/OECD Policy Guidance - Financial Consumer Protection Approaches in the Digital Age (2018)</i>	<u>Lidhje deri te G20/OECD – Udhëzues për qasje për mbrojtjen e konsumatorëve financiar në epokën digjitale</u>
6. <i>G20/OECD INFE Policy Guidance Digitalisation and Financial Literacy</i>	<u>Lidhje deri te G20/OECD/GPFI – Udhëzues për digjitalizimin dhe arsimin financiar</u>

(2018)	
7. <i>Personal Data Use in Financial Services and the Role of Financial Education (2020) - A Consumer-Centric Analysis</i>	Lidhje deri te OECD – Përdorimi i të dhënave personale për shërbime financiare dhe roli i edukimit financiar
8. <i>G20 High-Level Principles for Digital Financial Inclusion (2016)</i>	Lidhje deri te G20/GPFI – Parime për përfshirje digjitale financiare
9. <i>Digital Identity (2020)</i>	Lidhje deri te FATF – Udhëzues për identitetin digjital
10. <i>National Strategies for Financial Education OECD/INFE policy handbook (2015)</i>	Lidhje deri te INFE-OECD – Udhëzues për strategji nacionale për edukim financiar
11. <i>Good practices for financial consumer protection, WB (2017)</i>	https://www.worldbank.org/en/topic/financialinclusion/brief/2017-good-practices-for-financial-consumer-protection
12. <i>Joint Committee (JC) Guidelines on complaints handling, EBA (2018)</i>	https://eba.europa.eu/sites/default/documents/files/documents/10180/2298559/b71d60e8-1ee2-4baa-844d-26760f11c80d/Extension%20of%20the%20Joint%20Committee%20Guidelines%20on%20complaints-handling%20%28JC%202018%2035%29.pdf

Shtojca 2: Listë e institucioneve dhe shoqatave të kyçura

- Institucione rregullatore të sistemit financiar (nënshkruese)

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut
 Ministria e financave e Republikës së Maqedonisë së Veriut
 Agjencia e mbikëqyrjes së sigurimeve
 Agjencia për mbikëqyrjen e financimit kapital të sigurimit pensional

Komisioni i letrave me vlerë

- **Institucione të tjera shtetërore (bashkëpunëtorë të këshilluar)**

Byroja e zhvillimit të arsimit

- **Shoqata të subjekteve private financiare nga segmente të veçuara të tregut dhe subjekte private financiare (tek të cilët ishte e dorëzuar Strategjia për këshillim)**

Asociacioni Bankar i Maqedonisë

Grupacioni i sigurimeve

Asociacioni i shtëpive të brokerimit për sigurime

Unioni i organizatave mikrofinanciare

Shoqëri private pensionale

Bursa e Maqedonisë

Depozitari qendror i letrave me vlerë

Shtëpi brokerimi

Shoqëri administruese të fondeve investuese

Asociacioni i shoqërive financiare

- **Shoqata nga sektori civil (tek të cilët është dorëzuar Strategjia për këshillim)**

Organizata e konsumatorëve të Maqedonisë

Global shejpers Skopje hab Shkup

SIGMA STAT Shkup

Shoqata e klientëve bankar ANUITET

Shparkase fondacioni për bashkëpunim ndërkombëtar

Xhunioni aqivment Makedonija

Instituti për hulumtime strategjike dhe edukim

Romalitiko - Shkup

Rrjeti ndëraktiv për arsim dhe resurse - Manastir

- **Institucione të këshilluara ndërkombëtare:**

INFE-OECD